



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2911 Prot.

Lezhë, më 04 . 03 . 2024

VENDIM

Nr. 17, Datë 29. 02. 2024

**“PËR
PËRFSHIRJEN NË PRIORITETET E VITIT 2024 “NDËRTIMIN E UJËSJELLËSIT PËR
FURNIZIMIN ME UJË TË PIJSHËM TË FSHATRAVE MERQI DHE RRABOSHTË”**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 23 “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike” pika 1 ”Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm”, Ligjin Nr 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, kërkesën për shtesë prioriteti me Nr. 1679 Prot., Datë 08.02.2024 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit për “Ndërtimin e ujësjellësit për furnizim me ujë të pijshëm të fshatrave Mërqi dhe Rraboshtë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Përfshirjen në prioritetet e vitit 2024 “Ndërtimin e Ujësjellësit për furnizimin me ujë të pijshëm të fshatrave Merqi dhe Rraboshtë”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI
NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 216/16 Prot.

Lezhë, më 07.03.2024

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", nenin 23 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 17, datë 29.02.2024 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për përfshirjen në prioritetet e vitit 2024 "Ndërtimin e ujësjellësit për furnizimin me ujë të pijshëm të fshatrave Mërqi dhe Rraboshtë".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

